



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 99/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë dhe subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave më përmbajtje të fushatës parazgjedhore afër Qendrës së Votimit (QV) në fshatin Shipol komuna e Mitrovicës, gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e organizatës Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).
- II. Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- III. Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 24.01.2011, nga organizata BIRN, me te cilën pretendohet se më datë 23.01.2011 në QV1103B në shkollën fillore "Fazli Grajqevci" në fshatin Shipol komuna e Mitrovicës, është vërejtur materiali propagandues në afërsi më të vogël se 100 metra nga QV-ja dhe po ashtu në objekt të QV-së. Më tej parashtruesi i ankesës potencon se një poster i subjektit politik AAK ka qenë i vendosur në një objekt afër QV-së dhe një vizitkartë e një kandidati për deputet nga subjekti politik PDK ka qenë e vendosur në derë të QV-së. Me këtë parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e nenit 36 par. 1 pika (a) i LZP-së.

### **Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK dhe AAK, më datë 25.01.2011, për ankesën që është bërë ndaj këtyre subjekteve politike dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 26.01.2011, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjektet politike PDK dhe AAK, sipas afatit të caktuar.

### **Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit**

Dispozita ligjore e Nenit 36 paragrafi 1 pika (b) i LZP-së, dhe neni 6 paragrafi 1 pika (d) e *Rregullës Zgjedhore nr.11/2009* parashohin se:

*36.1 Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:*

*a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit.*

*b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se subjektet politike PDK dhe AAK kanë ekspozuar materialë propagandues te fushatës parazgjedhore të kandidatëve të tyre për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, gjatë procesit të rivotimit të datës 23.01.2011 në QV1103B në shkollën fillore “Fazli Grajqevci” në fshatin Shipol komuna e Mitrovicës. Materiali i lartë përmendur shihet nga shkresat e lëndës se është më afër se 100 metra nga QV-ja e lartcekur. Andaj për këtë arsye PZAP konstaton se ekspozimi i çfarëdo materiali çoftë ai me përmbajtje të fushatës parazgjedhore në afërsi më të vogël se 100 metra nga QV në ditën e votimit është shkelje e “KODIT TË MIRËSJELLËJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT” dhe është në kundërshtim më dispozitat e lartcekura ligjore. Prandaj për keto arsye si dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 99/2011 më datën 26.01.2011

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

